



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.538/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar: me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Milot Deliu kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Shtime nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Milot Deliu kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.10.2017, nga Milot Deliu kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës PDK i cili pretendon se në shkollën fillore “Idriz Ajeti” e përdorur si Qendër e Votimit QV 2209e/02D kandidati me nr.14 nga radhët e subjektit politik PDK, është vërejtur përmirësimi i votave të subjektit politik, veprime këto të dëshmuara me fakte provuese, duke theksuar se numëri i votave të subjektit politik është 160, kurse numëri i votave për kandidatë të subjektit politik PDK është 234.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në Qendrën e Votimit QV 2209e/02D, në shkollën fillore “Idriz Ajeti”, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatit e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Milot Deliu, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.538/2017 më datën 31.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

